



Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren
University "Ukshin Hoti" Prizren

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerziteti Prizren "UKSHIN HOTI"	
Pranuar me dt.	11.05.2022
Zyra e pranimimit	Nr. i protokollit
308	01-195

KËSHILLI DREJTUES

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren - Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Kryesues i Këshillit Drejtues
Prof. Asoc. Dr. Arif Murrja

Prizren, më 11.05.2022

Në mbështetje të nenit 178 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, Këshilli Drejtues i Universitetit të Prizrenit, në mbledhjen e mbajtur më 28.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Kodi i Etikës për Personelin e Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi do të jetë edhe Kodi i Etikës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Prof. Asoc. Dr. Arif Murrja

Kryesues i Këshillit Drejtues

Vendimi i dërgohet:

- Këshillit Drejtues;
- Menxhmentit;
- Zv. Sekretarit të Përgjithshëm;
- Personelit të Universitetit;
- Njësive Akadematike;
- Zyrës Ligjore;
- Arkivit.



 Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerziteti Prizrenë "UKSHIN HOTI"	
Pranuar më dt.	11.05.2022
Zyra e pranimit	Nr. I protokollit
308	01-195/4



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000
 Prizren, Republika e Kosovës
www.uni-prizren.com

KODI I ETIKËS

PËR PERSONELIN E UNIVERSITETIT "UKSHIN HOTI" PRIZREN

Prizren, 2022



Bazuar në dispozitat e Nenit 178 të Statutit, pas propozimit të Senatit, Këshilli Drejtues i Universitetit “Ukshin Hoti” Prizren, në mbledhjen e mbajtur më 28.03.2022, miratoi:

KODIN E ETIKËS PËR PERSONELIN E UNIVERSITETIT “UKSHIN HOTI” PRIZREN

Neni 1 Qëllimi

1. Përmes Kodit të Etikës, Universiteti do të promovojë vlerat më të larta të sjelljes dhe etikës për personelin akademik dhe joakademik të Universitetit “Ukshin Hoti”, duke respektuar lirinë akademike dhe parimet e tjera të cilat i promovon Statuti i Universitetit dhe ky kod.
2. Kodi i Etikës ka për qëllim të vendosë rregulla të sjelljes për personelin e Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren (tutje Universiteti), duke përfshirë personelin akademik, ndihmës, mësues, shkencor dhe administrativ, sipas standardeve të vendosura, në përputhje me frymën e etikës akademike dhe profesionale të punës, duke respektuar lirinë akademike, parimin bazë të zbatimit dhe ruajtjes së vlerave themelore të Universitetit.
3. Materia e këtij kodi etik respekton parimet e mishëruar në Statutin e Universitetit.

Neni 2 Fusha e veprimit

1. Kodi i Etikës është i detyrueshëm për zbatim në Universitet, përfshirë personelin akademik dhe joakademik si dhe të gjitha njësitë organizative që janë pjesë e Universitetit.
2. Fushëveprimit të këtij kodi të etikës i nënshtrohen i gjithë personeli akademik dhe joakademik, pavarësisht nga lloji i kontratës së punës dhe statusit që kanë në Universitet, si personel i rregullt apo i angazhuar.

Neni 3 Misioni, vizioni dhe vlerat e Universitetit

1. Kodi Etik është në funksion të realizimit të misionit dhe vizionit të Universitetit si dhe promovimit të vlerave më të mira në frymën e dispozitave të Statutit të Universitetit dhe këtij kodi.
2. Kodi Etik do të zbatohet për të mbrojtur misionin, vizionin dhe vlerat e Universitetit.
 - 2.1. Misioni - Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren, është institucion akademik e konkurrues, i orientuar në ofrimin e edukimit cilësor, duke zhvilluar kërkime shkencore dhe duke kontribuar në inovacion, në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe komunitetit ku vepron në nivel lokal, kombëtar dhe më gjerë.



-
- 2.2. Vizioni - Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren - qendër e ekselencës akademike, e cila do t'u shërbejë studentëve, hulumtuesve dhe shoqërisë në fushat e IT-së, agrobiznesit dhe mjedisit, menaxhmentit dhe administrimit të biznesit, drejtësisë, gjuhësisë dhe edukimit duke u bazuar edhe në përparësitë e diversitetit etnik, gjuhësor dhe kulturor.
 - 2.3. Vlerat - Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren promovon dhe mbron vlerat universale, grupe dhe individuale si në vijim:
 - 2.3.1. Liria e shprehjes dhe punës akademiko-shkencore, në mënyrë që të sigurohet shprehja e mendimit ndryshe;
 - 2.3.2. Cilësia në procesin e edukimit dhe punës kërkimore shkencore;
 - 2.3.3. Konkurrueshmëria brenda Universitetit si vlerë e shtuar e zhvillimit akademik dhe shkencor;
 - 2.3.4. Liria akademike e personelit akademik;
 - 2.3.5. Transparenca dhe liria e shprehjes e mendimit kritik;
 - 2.3.6. Kohezioni me kërkesat e tregut të punës;
 - 2.3.7. Meritokracia si vlerë universale e njohjes së kontributeve individuale dhe grupe;
 - 2.3.8. Diversiteti linguistik, etnik dhe kulturor si vlerë e shtuar burimore nga makromjedisi i rajonit të Prizrenit;
 - 2.3.9. Barazia sociale dhe gjinore dhe fuqizimi i rolit të gruas;
 - 2.3.10. Qëndrueshmëria financiare nëpërmjet diversifikimit të burimeve për financimin e punës së Universitetit;
 - 2.3.11. Barazia dhe antidiskriminimi;
 - 2.3.12. Praktikant e mira akademike;
 - 2.3.13. Bashkëpunimi i ngushtë me komunitetin e biznesit në nivel të rajonit të Prizrenit, nacional dhe më gjerë;
 - 2.3.14. Promovimi i punës së personelit të Universitetit, në tregun vendor dhe ndërkombëtar.
 3. Zbatimi i këtij kodi bëhet me synimin për mbrojtjen misionit, vizionit dhe vlerave të Universitetit, cenimi i të cilave nga palët që afekton ky kod etik nënkupton sjellje joetike.

Neni 4

Parimet etike të personelit të Universitetit

1. Integriteti i personelit akademik të Universitetit shprehet kryesisht përmes përsosmërisë profesionale dhe sjelljes etike.
2. Personeli akademik dhe joakademik, në bazë të detyrave të punës, do të angazhohet që të veprojë me një etikë të lartë dhe rigorozë, duke u bazuar në standardet më të larta profesionale.
3. Sjellja e personelit akademik dhe joakademik në bazë të standardeve më të larta etike mishëron vizionin e tyre dhe vendosmërinë për zhvillimin e Universitetit.



4. Manifestimi i tolerancës nga personeli i universitetit dhe nga studentët mundëson pranimin e diversitetit brenda Universitetit.

Neni 5

Përhapja e dijes, liria akademike dhe mësimdhënia

1. Në frymën e dispozitave të Statutit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, Universiteti inkurajon personelin që të angazhohet për të dhënë kontribut edhe në komunitetin që e rrethon në fushën profesionale së cilës i takon, duke krijuar lidhje të komunikimit ndërmjet Universitetit dhe institucioneve publike, private ose individë, me synimin që kapacitetet profesionale të Universitetit të jenë edhe në shërbim të komunitetit.
2. Personeli akademik i Universitetit gëzon liri akademike në kërkime, në punime shkencore dhe në metodologjinë e mësimdhënies.
3. Personeli akademik vepron mbi bazën e pavarësisë intelektuale, e cila mundëson qëndrim kritik ndaj çështjeve të ndryshme në mjedisin shoqëror dhe në veprimtarinë kërkimore apo profesionale.
4. Personeli akademik i Universitetit duhet t'i përmbahet zbatimit të përgjegjshëm të lirisë akademike, duke iu nënshtruar një programi mësimor të miratuar. Ata/ato duhet të realizojnë me përgjegjësi të lartë kërkimin, mësimdhënien dhe praktikën, nëpërmjet leximit, studimit, eksperimentit, vëzhgimit, shkëmbimit dhe vetëvlerësimit objektiv duke zgjedhur metoda dhe mënyra efikase, të dobishme, të kuptueshme dhe frytdhënëse për studentët.
5. Çdo anëtar i personelit akademik duhet të njohë dhe të respektojë kontributet shkencore të kolegëve dhe të studentëve. Në mësimdhënie, publikime ose prezantime, personeli akademik i Universitetit duhet të përdorë praktikën e pranueshme profesionale për materialet e huazuara.
6. Personeli akademik duhet të përmirësojë vazhdimisht metodologjinë, në mënyrë që të kenë efektivitet në mësimdhënie, të inkurajojë studentët për të vepruar në mënyrë të lirë dhe të pavarur, si dhe t'u shpjegojë atyre metodat e vlerësimit.
7. Personeli akademik duhet t'u shpjegojë paraprakisht studentëve objektivat e kursit, duke e realizuar këtë nëpërmjet leksioneve, demonstrimit, praktikës dhe provimeve.
8. Personeli akademik duhet të tregohet transparent në vlerësimet dhe testimet e njohurive të studentëve, në metodologjinë e përdorur dhe në rezultatet e tyre, duke vepruar konform Rregullores së Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren.
9. Mbi bazën e jetësimit të lirisë akademike, personeli akademik duhet të shprehë lirshëm mendimin e tij/saj, pa cenuar integritetin, personalitetin, dinjitetin dhe punën shkencore të kolegëve të tjerë.
10. Personeli akademik i Universitetit duhet të vlerësojë me korrektësi studentët dhe në raport me punën e tyre në procesin mësimor, hulumtime dhe veprime të tjera të veprojë sipas standardeve më të larta etike.
11. Personeli akademik i Universitetit inkurajon ndjekjen e lirë të mësimnxënies të studentët e tyre.



12. Personeli akademik i Universitetit ndërmerr secilin veprim për të nxitur krijimtarinë shkencore të studentët e tyre dhe vlerësimin korrekt dhe meritore të kësaj krijimtarië shkencore.
13. Personeli akademik i Universitetit respektonë qasjen konfidenciale në raport me studentët, përkitazi me vlerësimin dhe punën individuale dhe grupore me studentët e tyre.
14. Trajtimi i barabartë, mosdiskriminimi, siguria nga çfarëdo lloj ngacmimi ose vlerësimi jo etik dhe vlera të tjera që promovon ky kod i garantohet secilit student pa asnjë përjashtim. Trajtimi jo i barabartë, diskriminimi, ngacmimi apo çfarëdo forme tjetër të vlerësimit joetik të personelit akademik dhe jo akademik, ndaj studentëve është i ndaluar.

Neni 6

Detyrimet e personelit ndaj Universitetit në raport me Kodin e Etikës

1. Çdo anëtar i personelit akademik dhe joakademik të Universitetit, gjatë kryerjes së detyrës duhet të udhëhiqet nga parimet e cekura në Nenin 3 të këtij kodi, si dhe në vazhdimësi të angazhohet që:
 - 1.1. Të promovojë interesat e Universitetit;
 - 1.2. Të promovojë misionin, vizionin dhe vlerat e Universitetit;
 - 1.3. Të kontribuojë në ndërtimin, ruajtjen, respektin dhe besimin e publikut ndaj Universitetit dhe integritetit të tij;
 - 1.4. Të ruajë dhe të mbrojë reputacionin e Universitetit;
 - 1.5. Të shfaqë dhe të reflektojë integritet personal, ndershmëri dhe përgjegjësi në të gjithë veprimet e tij/saj, jashtë dhe brenda ambienteve të Universitetit;
 - 1.6. Të angazhohet për të siguruar një ambient të respektit reciprok, të paanshmërisë dhe bashkëpunimit;
 - 1.7. Të ruajë fshehtësinë e të gjitha çështjeve që konsiderohen konfidenciale;
 - 1.8. Të shmangë situatat që marrëdhëniet që janë ose mund të perceptohen si konflikte interesi, të jenë plotësisht të hapura dhe të ndiqen nga udhëzimet e organeve drejtuese të Universitetit;
 - 1.9. Të veprojnë në harmoni dhe të zbatojnë politikën dhe procedurat e Universitetit, statutin dhe ligjet në fuqi;
 - 1.10. Të demonstrojnë përkujdesje ndaj pronës dhe burimeve të Universitetit;
 - 1.11. Të respektojnë detyra e punës të përcaktuara me statut dhe sipas kontratës së punës me Universitetin;
 - 1.12. Të respektojnë orarin e punës, orarin mësimor të miratuar dhe ndryshimet e tij në çdo rast;
 - 1.13. Të ruajë një paraqitje serioze gjatë orarit të punës, që përfshin veshje serioze e dinjitoze, përdorimin e një fjalori të zgjedhur dhe brenda normave të etikës e të sjelljes qytetare;



- 1.14. Të mos lejojë që marrëdhëniet personale të prekin marrëdhëniet profesionale;
 - 1.15. Të mbajë raport korrekt dhe sjellje korrekte në ambientin e punës;
 - 1.16. Të mos kërkojë dhe të mos pranojë në asnjë formë privilegje, përfitime, ndërhyrje, favorizime, pagesa apo dhurime, nga studentë apo persona të tjerë, që kanë për qëllim marrjen e rezultateve favorizuese, të pamerituara prej tyre, apo favore e përfitime të tjera të cilat anëtari i personelit mund t'i kryejë për shkak të detyrës dhe të shmangë situatat e tilla;
 - 1.17. Të mos bëjë dallime ndër studentë, vartës apo kolegë për shkak të njohjeve apo preferencave personale dhe të aplikojë parimin e barazisë;
 - 1.18. Të mos bëjë dhe të mos bjerë nën ndikimin e provokimeve, ngacmimeve të të gjitha formave nga studentët apo personave të tjerë për shkak të punës, për qëllime që bien në kundërshtim me këtë kod, aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe me normat morale;
 - 1.19. Me veprimet e tij të mos sjellë cenime të dinjitetit, të personalitetit dhe të figurës profesionale, mendimeve profesionale të kolegëve dhe autoriteteve drejtuese të çdo niveli, pavarësisht mospërputhjeve dhe konfliktit të interesave;
 - 1.20. Të mos bëjë veprime që, për të cilat ai/ajo është në dijeni që janë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi;
 - 1.21. Të mos përdorë autoritetin për aktivitete që nuk lidhen me mësimdhënien, apo për të fyer dhe diskriminuar studentët, për të fyer, shpifur apo diskutuar për kolegët dhe autoritetet drejtuese të çdo niveli për çfarëdo lloj arsyeje apo konflikti;
 - 1.22. Të respektojë vendimet e organeve të Universitetit, siç përcaktohet në Statut dhe rregulloret e tjera në fuqi, brenda Universitetit;
 - 1.23. Të veprojë sipas standardëve më të mira të hulumtimit dhe krijimtarisë shkencore e profesionale, duke mos cenuar ndashmërinë akademike;
 - 1.24. Të respektojë marrëdhënien e punës duke mos pasur angazhime të tjera të cilat e dëmtojnë angazhimin e tij/saj primar në Universitet;
 - 1.25. Të përmbushë me përpikëri obligimet që dalin nga kontrata e tij/saj e punës;
 - 1.26. Të respektojë dispozitat e ligjit mbi përdorimin e duhanit, pijeve alkoolike dhe substancave të tjera, në ambientet e Universitetit ose kur prezanton Universitetin.
2. Cenimi i obligimeve të përcaktuara në këtë nen, gjatë kryerjes së detyrave të punës për personelin akademik, nënkupton dhe trajtohet si shkelje etike.

Neni 7

Politikat antidiskriminuese të Universitetit

1. Universiteti i ofron mundësi të barabarta çdo personi gjatë procesit të rekrutimit, emërtimit, promovimit, trajnimeve dhe praktikave të tjera të zbatuara në Universitet, pa dallim gjinie, race, origjine etnike, origjine kombëtare, ngjyre, besimi, feje, gjendjes ekonomike arsimore ose shoqërore, identiteti gjinor, orientimi seksual, aftësisë së kufizuar, bindjeve politike ose për çdo shkak tjetër.



2. I gjithë personeli akademik i Universitetit duhet të përshtatet me politikën antidiskriminuese të Universitetit dhe në pajtueshmëri me Kushtetutën dhe Ligjin kundër diskriminimit.
3. Universitetit dhe personeli i tij, përmes këtij kodi etik dhe zbatimit të tij zotohet për zbatimin e legjislacionit në fuqi për mbrojtje nga diskriminimi, në të gjitha fushat e përcaktuara nga ky legjislacion.

Neni 8

Konfidencialiteti i informacionit në Universitet

1. Personelit të Universitetit i është besuar mbajtja dhe njohuritë e të dhënave personale dhe institucionale, informacione të të punësuarve në çfarëdo cilësie ashtu edhe studentëve, të cilat duhet të trajtohen me konfidencialitet dhe të përdoren vetëm për kryerjen e punës në Universitetit.
2. Respekti për privatësinë personale dhe individuale kërkon ushtrimin e kujdesit dhe të gjykimit. Përveç rasteve kur kërkohet ose lejohet nga ligjet apo rregullat e Universitetit, informacionet, të dhënat personale ose institucionale të personelit akademik dhe joakademik si dhe të studentëve, nuk duhet t'u jepen palëve të treta pa pëlqimin e individëve në fjalë. Kur ekziston dyshimi në lidhje me konfidencialitetin e informacionit, anëtarët e personelit të Universitetit duhet të konsiderojnë informacionin si konfidencial deri në marrjen e një vendimi ndryshe.
3. Zbulimi i informacionit konfidencial, në dosjet e personelit akademik, joakademik dhe studentëve do të sanksionohet me masa disiplinore dhe përbën shkelje të këtij kodi etikës. Parimi i konfidencialitetit përmes këtij kodi promovohet si vlerë, para se të trajtohet si obligim ligjor.

Neni 9

Përdorimi i emrit dhe statusit të Universitetit dhe sjellja jashtë e personelit

1. Kur flasin ose veprojnë si persona privatë jashtë Universitetit, personeli akademik dhe joakademik i Universitetit dhe studentët respektojnë vlerat dhe standardet etike të përcaktuara në këtë kod.
2. Personeli i Universitetit nuk mund të përdorë ose të lejojë përdorimin e emrit ose logos së Universitetit, ose të identifikojë veten si anëtar i personelit të Universitetit në promovime, reklama ose produkte komerciale pa pëlqimin paraprak me shkrim nga organet kompetente të organeve kompetente në Universitetit, sipas Statutit.
3. Individët, pjesë e personelit të Universitetit të cilët flasin ose shkruajnë publikisht si ekspert ose profesionist të një fushe të caktuar mund të identifikojnë veten e tyre me marrëdhënien që ata kanë me Universitetin, por nëse identifikohen, në mënyrë të tillë në të gjitha rastet kur ai mund të jap përshtypjen e të folurit në emër të Universitetit, duhet të tregojnë kujdes të theksohet se çdo pikëpamje e shprehur është e individit dhe nuk prezanton ose përfaqëson atë të Universitetit.
4. Personeli akademik dhe joakademik i Universitetit mund të kontribuojnë në debatet publike si qytetarë. Në rastet kur personeli i Universitetit komenton publikisht si pjesë e



detyrave të tyre zyrtare, ata duhet ta bëjnë duke përdorur adresat zyrtare elektronike të Universitetit, dhe kur komentojnë si qytetarë të përdorin adresat elektronike të tyre personale. I gjithë personeli duhet të përdorë adresat individuale elektronike zyrtare për të komunikuar për çështje që kanë lidhje me punën, për të shkëmbyer informacione formale dhe zyrtare.

5. Dëmtimi i imazhit së Universitetit gjatë përdorimit të emrit dhe statusit në publik nga ana e personelit përbën shkelje etike.
6. Personeli akademik dhe joakademik i Universitetit kanë të drejtë t'u bashkohen partive politike, në përputhje me legjislacionin në fuqi, shoqatave profesionale dhe grupeve të interesit, bashkësive fetare dhe organizatave të tjera legale dhe mund të shprehin mendimet e tyre si persona privatë. Kur flasin ose veprojnë si persona privatë, ata shmangin konfliktin e mundshëm të interesit, në mënyrë që aktivitetet e tyre të mos bien ndesh me përgjegjësitë dhe detyrat e tyre në Universitetit.

Neni 10

Burimet e Universitetit

1. Personeli i Universitetit është përgjegjës për burimet infrastrukturore, shkencore dhe burimet e tjera të Universitetit.
2. Personelit të Universitetit i është besuar menaxhimi, mbrojtja e pasurisë, pajisjeve dhe asetëve të Universitetit, ndaj duhet të demonstrojnë e ushtrojnë përgjegjësi, sjellje etike përgjatë kohës së përdorimit të burimeve të Universitetit. Në disa situata të caktuara personeli akademik dhe joakademik mund të përdorë pajisjet infrastrukturore dhe shkencore jashtë kornizës së detyrës së tij, por atëherë kur qëllimi i tij përputhet me atë të Universitetit. Çdokush në një rast të tillë duhet të ketë miratim me shkrim nga personi përgjegjës ose administratori i vendndodhjes së pajisjes sikurse duhet të jetë në gjendje të rimbursojë të gjithë koston e përdorimit të pajisjes infrastrukture dhe shkencore. Shfrytëzimi i pajisjeve duhet të bëhet në bazë standardeve më të larta etike.
3. Personeli i Universitetit gjatë punës sipas kompetencave apo angazhimit në komisione ose në çfarë do angazhimi tjetër, me përgjegjësi etike dhe morale do të shfrytëzojë pasurinë e universitetit në përputhje me autorizimet ligjore, duke u angazhuar në eliminimin çdo forme të shpërdorimit të pasurisë ose burimeve të Universitetit duke u udhëhequr nga parimi i ekonomizimit dhe përdorimit efikas të burimeve).

Neni 11

Ngacmimet

1. Universiteti angazhohet për të krijuar një ambient pune pa asnjë lloj ngacmimi.
2. Inkurajohen personeli akademik, joakademik si dhe studentët që të kenë rol aktiv kundër dukurive të tilla negative duke i denoncuar ato në organet përkatëse të Universitetit.
3. Ndalohet ngacmimi verbal, dhe joverbal i të gjitha llojeve ndaj studentëve dhe çdo anëtar tjetër të personelit të Universitetit në çdo nivel hierarkie. Çdo ankesë për ngacmimet e lartpërmendura, të shoqëruara edhe me fakte, do të hetohet dhe trajtohet



me të gjitha mënyrat e aprovuara nga Këshilli i Etikës i Universitetit si dhe do të adresohet në bazë të legjislacionit në fuqi.

4. Ngacmimet verbale, me shkrim, dhe të gjitha llojet e ngacmimeve të tjera, qoftë në formë fizike ose verbalisht, cilësohen si shkelje të rënda të Kodit të Etikës.

Neni 12

Marrëdhëniet personale dhe kolegiale

1. Personeli akademik dhe joakademik kanë obligime të sjelljes korrekte dhe etike ndaj njëri-tjetrit, në ambientin e punës brenda Universitetit. Personeli akademik ka për obligim që të sillet me njëri-tjetrin, duke respektuar standardet më të larta etike që çon në respektimin e idesë, mendimeve të njëri-tjetrit dhe kritikave konstruktive.
2. Ndalohet sjellja jonjerëzore dhe joprofesionale, e bazuar në baza të diskriminimit ndaj kolegut/es tjetër, nga personeli akademik dhe joakademik i Universitetit. Personeli akademik dhe joakademik në marrëdhëniet ndër personale dhe kolegiale duhet të ndajnë interesin privat dhe atë publik/zyrtar.

Neni 13

Konflikti i interesit

1. Personeli akademik dhe joakademik të Universitetit duhet të shmangin sjelljet që çojnë anëtarët e publikut të gjerë të konkludojnë se ai/ajo po përdor postin e tij për interes vetjake profesionale ose interesa të ndonjë të afërmi të tij dhe që ndikon ose mund të ndikojë në paanshmërinë ose objektivitetin e kryerjes së detyrës së tij.
2. Individët të cilët janë në pozicione drejtuese të shmangin rastet kur ka konflikt interesi sipas legjislacionit në fuqi, duke i deklaruar ato përpara eprorit sapo të jenë shfaqur. Kur ekzistojnë konflikte të tilla, anëtari është i detyruar të tërhiqet nga proceset vendimmarrëse ose aktivitetet e ngjashme.
3. Kur anëtari i personelit ka dijeni se një situatë e tillë ekziston, ai është i detyruar që ta trajtojë atë në përputhje me legjislacionin në fuqi:
 - 3.1. Të verifikojë nëse ka një konflikt aktual të mundshëm interesi;
 - 3.2. Të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të shmangur një konflikt të tillë;
 - 3.3. Të vërë në dijeni menjëherë, me nismën e tij, eprorin dhe njësinë e personelit për konfliktin aktual ose të mundshëm të interesit;
 - 3.4. Në rast dyshimi për gjendjen në një situatë konflikti interesi, këshillohet menjëherë me eprorin ose/dhe me njësinë e personelit të Universitetit;
 - 3.5. T'i bindet çdo vendimi përfundimtar, për të mos marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes ose të heqë dorë nga përparësitë që shkakton konflikti i interesit.
4. Personeli akademik dhe joakademik duhet të ndërmarrë të gjitha masat që të parandalojë dhe të shmangë konfliktin e interesit i cili ka lindur ose mund të lindë. Konflikti i interesit nuk mund të nënkuptohet, sipas këtij kodi, kur zbatohet Statuti dhe rregulloret e brendshme të Universitetit.



5. Personeli akademik dhe joakademik duhet të trajtojë çështjen e konfliktit të interesit, duke pasur parasysh legjislacionin në fuqi.

Neni 14

Shërbimet administrative dhe çështjet etike

1. Për të kryer efektivisht nga personeli akademik dhe joakademik përgjegjësitë administrative dhe ato të auditimit, instancat përkatëse duhet të jenë të pavarura dhe të garantojnë objektivitet.
2. Përbën shkelje të kodit të etikës të mashtros, të japësh informacion të rremë ose të heqësh qëllimisht material si dhe fakte nga auditimit.
3. Personeli akademik (që ka përgjegjësi administrative) dhe personeli joakademik, personeli ndihmës mësimor-shkencor, personeli i teknologjisë informative, personeli administrativ, drejtuesit e njësive akademike dhe administrative si dhe organet kolegjiale duhet të zbatojnë me etikë, korrektësi dhe përpikëri të gjitha përgjegjësitë që u janë përcaktuar me statut dhe kontratën e punës.

Neni 15

Dhuratat dhe favorët në raport me aspektin etik

1. Personeli i Universitetit nuk duhet të kërkojë ose të pranojë, dhurata, favore, ose çfarëdo përfitim tjetër, ose shmangie të humbjeve të mundshme, si dhe premtime për to, për veten, familjen, të afërmit, personat ose organizatat me të cilat ka marrëdhënie pune, që ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në paanësinë e kryerjes së detyrës, janë ose duket sikur janë shpërblim për mënyrën e kryerjes së detyrës zyrtare.
2. Asnjë nga personeli akademik dhe joakademik nuk duhet të pranojë asnjë lloj shpërblimi, monetar ose jomonetar, në qoftë se ka një supozim të qartë ose të nënkuptuar se ai është shkëmbyer për favor.
3. Në rast dyshimi ose paanshmërinë e përfitimeve, personeli këshillohet me njësinë e vet akademike. Për çdo lloj dhurate të dhënë ose pranuar nga anëtari i personelit të Universitetit duhet zbatuar legjislacioni përkatës në fuqi.
4. Në qoftë se anëtarit të personelit i ofrohet një avantazh i padrejtë, ai duhet:
 - 4.1. Ta refuzojë, pa pasur nevojë të pranojë atë për ta përdorur si provë;
 - 4.2. Të përpiket që ta identifikojë personin që i bën ofertën;
 - 4.3. Të shmangë kontaktet e gjata me personin që bëri ofertën, por dijenia e arsyes për të cilën bëhet oferta, mund të shërbejë si provë;
 - 4.4. Në qoftë se dhurata nuk mund të refuzohet që t'i kthehet dërguesit, duhet të ruhet, të përdoret sa më pak që të jetë e mundur dhe t'i raportohet menjëherë eprorit;
 - 4.5. Të ketë dëshmitarë, nëse është e mundur, kolegët që punojnë me të;
 - 4.6. Të raportojë përpjekjen, sa më shpejt që të jetë e mundur, tek eprori i tij ose te njësia e personelit;
 - 4.7. Të vazhdojë punën normalisht, sidomos për problemin për të cilin avantazhi i padrejtë është ofruar.



5. Marrja dhe pranimi i dhuratave, ndërlidhur me detyrën zyrtare, konsiderohet shkelje e rëndë e Kodit të Etikës. Dhuratat dhe favorët trajtohen sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Neni 16

Format e komunikimit të personelit

1. Komunikimi me shkrim është i domosdoshëm për të siguruar një standard etik të qasjes në komunikim brenda Universitetit dhe për të shmangur keqkuptimet që mund të lindin si pasojë e komunikimit verbal.
2. Në kuptim të zbatimit të këtij kodi etik, format e komunikimit me shkrim janë dy: shkresat zyrtare dhe komunikimet nëpërmjet postës elektronike.
3. Të gjithë mesazhet e hartuara dhe/ose të dërguara nëpërmjet rrjetit të brendshëm të Universitetit duhet të jenë në pajtim me Ligjin, Statutin, Rregulloret dhe Kodin e Etikës dhe të respektojnë rregullat e komunikimit zyrtar, ruajtjen e privatësisë dhe fshehtësisë së të dhënave siç kërkohet me ligj.
4. Komunikimi përmes adresës së postës elektronike zyrtare përdoret në përputhje me qëllimin e destinuar dhe vetëm për nevoja zyrtare.
5. Struktura e shkresave zyrtare brenda institucionit (Memo) bëhet duke zbatuar rregullat e përcaktuara nga Universitetit, me qëllim të mbrojtjes së imazhit dhe kredibilitetit të Universitetit.

Neni 17

Pasuria intelektuale e Universitetit

1. E gjithë prona intelektuale e konceptuar, e prodhuar ose e shkruar nga fakultetet, stafi administrativ, studentët duke përdorur fondet e Universitetit, objektet ose burime të tjera duhet të jenë në pronësi dhe të kontrolluara nga Universiteti.
2. Prona intelektuale e Universitetit mbrohet sipas legjislacionit në fuqi.
3. Cenimi i pronësisë intelektuale të Universitetit dhe pronës intelektuale së personelit akademik dhe joakademik, të krijuar trajtohet si shkelje e këtij kodi të etikës.

Neni 18

Ndershmëria akademike dhe e hulumtimit

1. Ndershmëria kërkimore përfshin respektimin e vazhdueshëm të së drejtës së autorësisë, njohjen e arritjeve kërkimore të studiuesve të tjerë, përdorimin e vazhdueshëm të metodave të duhura kërkimore, interpretimin e drejtë dhe profesional të rezultateve, raportimin e sakte të të dhënave, dhe shqyrtimin objektiv të hipotezave kërkimore.
2. Plagjiatura paraqet shkelje të Kodit të Etikës dhe zbatohen përshtatshëm dispoziat ligjore të Ligjit për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të përafërta dhe rregulloret e brendshme të Universitetit.



3. Personeli akademik i Universitetit që kryen analiza politike si ekspertë sipas standardeve akademike mund t'i paraqesin gjetjet e tyre ose para publikut të gjerë ose gjatë kurseve të tyre.

Neni 19

Zbatimi i Kodit të Etikës

1. Personeli akademik dhe joakademik, bazuar në këtë kod të etikës, janë të obliguar që të raportojnë shkeljet në organet kompetente që e zbatojnë këtë kod të etikës.
2. Senati i Universitetit zgjedh Këshillin e Etikës, i cili do të ketë 5 (pesë), përfshirë 3 anëtarë nga radhët e mësimdhënësve të Universitetit, 1 (një) anëtar nga stafi administrativ (joakademik) i Universitetit dhe 1 (një) anëtar i zgjedhur nga Parlamenti i Studentëve të Universitetit.
3. Mandati i anëtarëve të zgjedhur nga stafi akademik dhe joakademik është katër (4) vjet. Mandati i anëtarit nga radha e studentëve është 2 (dy) vjet.
4. Kryetari i Këshillit të Etikës duhet të jetë njëri nga anëtarët e emëruar nga fusha profesionale e drejtësisë dhe emërimi i tij/saj bëhet me vendim nga Senati.
5. Këshilli i Etikës do të jetë përgjegjës për zhvillimin e procedurave disiplinore që do të shoqërojnë këtë kod të etikës, duke përfshirë edhe të drejtën për të organizuar seancë dëgjimore për secilin person të akuzuar për shkelje të këtij kodi dhe për të propozuar sanksionet për rastet e shkeljes së këtij kodi. Rregullorja për procedurat do të miratohet nga Këshilli Drejtues sipas propozimit të Senatit të Universitetit.
6. Këshilli i Etikës do të jetë përgjegjës për monitorimin e zbatimit të këtij kodi, duke përfshirë edhe ndryshimet dhe përmirësimet e rekomanduara.
7. Detyrat e detajuara të Këshillit të Etikës do të caktohen me rregulloret përkatëse disiplinore për personelin akademik dhe joakademik.
8. Me qëllim të zbatimit të këtij kodi të etikës, Këshilli Drejtues, në bazë të Nenit 23 të Statutit të Universitetit, nxjerr rregulloren për masat dhe procedurën disiplinore të personelit akademik.

Neni 20

Çështjet disiplinore dhe etike të studentëve të Universitetit

1. Çështjet e rregullave, masave dhe procedurave disiplinore për studentët e Universitetit, përcaktohen me rregullore të veçantë.
2. Rregulloren për masa dhe procedurën disiplinore për studentët e Universitetit e nxjerr Këshilli Drejtues, në bazë të Nenit 23 të Statutit.

Neni 21

Premtimi për moshakmarrje

1. Universiteti premtan se nuk do të ketë asnjë veprim të kundërt, hakmarrje ose hakmarrje tjetër për raportimin në mirëbesim të një shkeljeje të dyshuar të këtij kodi, edhe nëse pretendimet përfundimisht rezultojnë të pabaza. Megjithatë, Universiteti do të ndjekë



masa disiplinore kundër çdo anëtarë që tregohet se ka paraqitur me vetëdije një raport të rremë, me qëllim për të lënduar një tjetër.

Neni 22

Dispozitat përfundimtare

1. Kodi i Etikës hyn në fuqi pas miratimit nga Këshilli Drejtues dhe duhet të publikohet në ueb-faqen e Universitetit.
2. Pas hyrjes në fuqi të këtij kodi të etikës, Universiteti nxjerr rregulloret për zbatimin e tij.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij kodi të etikës, shfuqizohet Kodi i miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues, nr. 219/16, më datë 19.02.2016.
4. Duke u bazuar në këtë kod të etikës, Këshilli Drejtues, në kuptim të Nenit 178 të Statutit të Universitetit, nxjerr edhe rregullore të tjera që rregullojnë çështjet specifike të etikës në Universitet.
5. Universiteti rezervon të drejtën, në çdo kohë dhe pa paralajmërim, të ndryshojë këtë kod të sjelljes etike sipas gjykimit të tij të vetëm, me mirëbesim.
6. Ky kod nuk përbën kontratë.

Neni 23

Dispozitat kalimtare

1. Të gjitha rastet që janë duke u trajtuar aktualisht në Këshillin e Etikës së Universitetit, para hyrjes në fuqi të këtij kodi etik, trajtohen sipas kodit etik të miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues, nr. 219/16, të datës 19.02.2016.
2. Ky kod etik nuk mund të veprojë në mënyrë retroaktive në të drejtat e palëve që i afekton.

Kryesuesi i Këshillit Drejtues


Prof. Asoc. Dr. Arif Murteza

